

VENDIM
Nr. 10, datë 27.1.2016

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 157, DATË 28.12.2015, TË BORDIT TË ERE
“PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 99; 109; pika 4; dhe 5; 110; pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.1.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, të Bordit të ERE-s “Për miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- MEI ka shprehur qëndrimin me shkresën nr. 8379/1 prot., datë 8.1.2015, mbështetur në nenin 10, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pika 2 e tij: “ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë (MEI) dhe institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të ligjit”.

- “OSHEE” sh.a., ka shprehur qëndrimin e saj dhe ka propozuar shtyrjen e afatit të implementimit të ndryshimit të “Rregullave të tregut”, siç është propozuar me vendimin nr. 157, datë 28.12.2015.

- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se: “Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.”

- Në nenin 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është “OST” sh.a., përgjegjës për t’i propozuar ERE-s, “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, të cilat duhet të jenë në harmoni me modelin e tregut.

- Në nenin 97/3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është Këshilli i Ministrave organi përgjegjës që miraton modelin e tregut, pas propozimit të tij nga ministria e linjës.

- Ndërkohë, ende nuk kemi të miratuar një model të tregut të energjisë elektrike në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, të Bordit të ERE-s, duke ndryshuar pikën 1 të tij, si më poshtë:

“Me hyrjen në fuqi të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, pas miratimit të modelit të tregut në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “OSHEE” sh.a., “KESH” sh.a. dhe “OST” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti